



Ne ndodhemi pranë jush për të ofruar mbështetje dhe kujdes të përqëndruar në nevojat e tyre specifike. Nëse ju vetë ose ndonjë i njohur i juaj i përket kësaj kategorie dhe ka nevojë për shërbimet tona, ju lutemi të kontaktoni Shoqatën Ryder Albania nëpërmjet mënyrave të kontaktit të listuara më poshtë. Në rastet kur kontaktimi direkt me shoqatën nuk është i mundur, ju inkurajojmë të drejtoheni tek zyrat e njësisë administrative të zonës tuaj, ose të vizitoni çdo qendër komunitare të Bashkisë Tiranë për ndihmë dhe udhëzime të mëtejshme.

KU MUND TË NA GJENI ?

Shoqata Ryder Albania për t'ju ardhur në ndihmë të gjithë të interesuarve ndodhet vetëm fare pak metra larg Pazarit të Ri Tiranë, në :



Rruga "Vllazën Huta" Nd. 90, Hyrja Nr 4.



Tel: 0035542452309



Email: info@ryderalbania.org



Web: www.ryderalbania.org.al

Adresa është e aksesueshme përmes Linjave Qytetase të Transportit Urban:

- Linja Unaza e Re (500 metra nga Ura e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Evropës)
- Linja Kombinat Kinostudio (200 metra mbi Stacionin i Pazarit të Ri)
- Linja Tufinë (200 metra mbi Stacionin i Pazarit të Ri)
- Linja Porcelan (200 metra mbi Stacionin i Pazarit të Ri)



Ky publikim është realizuar nga Shoqata Ryder Albania në kuadër të Projektit "Ofrimi i shërbimit të kujdesit në shtëpi për të moshuarit, në Tiranë" në partneritet me Bashkinë Tiranë dhe financuar nga Bashimi Evropian.

Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e autorëve realizues dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian



"NË SHTËPINË TUAJ, ME DASHURI DHE KUJDES: SHËRBIME PËR TË MOSHUARIT"

Përkujdesje shoqërore, shëndetësore dhe asistencë shtëpiake për të moshuarit.



KUSH JEMI?

Shoqata Ryder Albania (SHRA) është një organizatë jofitimprurëse, e themeluar në Nëntor 1993, e përkushtuar në ofrimin e shërbimeve shëndetësore falas në shtëpi për pacientët me sëmundje kërcënuese për jetën, të moshuar me sëmundje kronike, dhe të tjerë.

Me një përvojë 30vjeçare, ne operojmë me dy ekipe në Tiranë dhe Durrës, duke ofruar kujdes shumëdisiplinar në shtëpi.

RRETH PROJEKTIT

Me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian, Shoqata Ryder Albania në partnerit me Bashkinë Tiranë, po zbaton projektin “Ofrimi i shërbimit të kujdesit në shtëpi për të moshuarit në Bashkinë Tiranë” që do të zgjasë 36 muaj.

Ky projekt ka për qëllim ofrimin e një shërbimi të integruar dhe të plotë: mjekësor, psikosocial dhe kujdestar, në banesat e të moshuarve që janë të sëmurë, të vetmuar dhe në nevojë, në të gjitha zonat urbane dhe rurale të Tiranës.

Projekti synon rritjen e cilësisë së jetës dhe promovimin e një jetese të pavarur dhe dinjitoze për të moshuarit.

MNYRAT E OFRIMIT TE SHËRBIMIT

Shërbimet ofrohen nga ekipi ynë multidisciplinar i përbërë nga mjekë, infermierë, punonjës socialë dhe kujdestarë, nga e hëna në të premte, **08:30-16:30.**

SHËRBIMET TONA PËRFSHIJNË:

- Përkujdesje e higjienës personale
- Përgatitja e vakteve ushqimore
- Mirëmbajtja e higjienës së shtëpisë
- Kryerja e pazarit dhe pagesat e faturave
- Dhënia e mjekimeve
- Shërbime mjekësore dhe infermieristike
- Shoqërim të mjeku familjes dhe/ose specialisti
- Aktivitete shoqërore dhe rikrijuese jashtë banesës
- Ndërmjetësim me institucione të tjera për nevoja social-ekonomike

SHËRBIMET TE TJERA:

Shërbimi ynë shëndetësor në banesë është i përqendruar në ofrimin e kujdesit të vazhdueshëm dhe të personalizuar për të moshuarit. Ky shërbim përfshin monitorimin e gjendjes shëndetësore dhe kontrollin e simptomave, si dhe manipulime mjekësore dhe infermieristike të tilla si menaxhimi i medikamenteve, matja e presionit të gjakut, trajtimi i plagëve dhe kujdesi për higjienën personale.

Shërbimet tona përfshijnë gjithashtu sigurimin e pajisjeve mjekësore si aparate oksigjeni, dyshekë antidekubitues dhe karrige me rrota për të përmirësuar cilësinë e jetës së të moshuarve.

Shërbimet tona psikosociale ofrojnë mbështetje emocionale për të moshuarit dhe familjarët e tyre, këshillime dhe ndihmë në lidhjen me burimet e komunitetit për çështje të tilla si pensioni, ndihma ekonomike, aplikime online për shërbime të ndryshme etj.

Ne ofrojmë, gjithashtu, shërbime të kujdestarisë në banesë, duke përfshirë asistencën në aktivitetet e përditshme, përgatitjen e ushqimeve, ndihmë në kryerjen e pazareve dhe në pagesat e shërbimeve të ndryshme. Shërbimi ynë synon të përshtatet me ritmin dhe dëshirat individuale të përfituesve, duke u mundësuar atyre pjesëmarrje në aktivitete sociale dhe familjare, edhe nëpërmjet shoqërimit në aktivitete jashtë banesës.

KUSH PËRFITON NGA KY SHËRBIM?

Shërbimi ynë është krijuar specifikisht për të ndihmuar të moshuarit në Bashkinë e Tiranës, veçanërisht ata që jetojnë vetëm, pa mbështetje familjare, që përballen me sfida si sëmundje, probleme psikosociale dhe vështirësi ekonomike.

